



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 23/ 01 / 2023

VENDIM

Nr. 03, date 23 /01/2023

PËR

RREGULLOREN E SHFRYTEZIMIT, OPERIMIT, MIREMBAJTJES, MONITORIMIT DHE SIGURISE SE DIGAVE TE SHFRYTEZUARA NGA BASHKIA RROGOZHINE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 23.01.2023 mori në shqyrtim Rregulloren e shfrytëzimit, operimit, mirembajtjes, monitorimit dhe sigurisë së digave që shfrytëzohen nga Bashkia Rrogozhine të paraqitur nga Bashkia Rrogozhine.

Rregullorja e përgatitur nga specialistët e Bashkisë Rrogozhine e dorëzuar pranë KKDM rezultoi se nuk është përgatitur në përputhje me kërkesat e KKDM për hartimin e rregulloresve përkatëse të shprehura në Vendimin e KKDM Nr. 3, dt.19.10.2020. Keshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) i rekomandoi antarëve të KKDM të mos miratojnë rregulloren e paraqitur për shfrytëzimin, operimin, mirembajtjen, monitorimin dhe sigurinë e digave të shfrytëzuara nga Bashkia Rrogozhine. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të mos miratojnë Rregulloren e Shfrytëzimit, Operimit, Mirembajtjes, Monitorimit dhe Sigurisë së digave të shfrytëzuara nga Bashkia Rrogozhine të paraqitur nga Bashkia Rrogozhine për arsye të mosplotësisë të kërkesave të Vendimit të KKDM Nr.3, datë 19.10.2020.
- 2- Ti kërkojë Bashkisë Rrogozhinë:
 - Rishikimin dhe përgatitjen e rregullores së shfrytëzimit, mirembajtjes, operimit dhe sigurisë së digave të mëdha të Sharrdushk, Patku 2, Okshtun të shfrytëzuara nga Bashkia Rrogozhine, në përputhje me vendimin e KKDM Nr. 03, datë 19.10.2020;
 - Përgatitjen dhe dorëzimin për miratim pranë KKDM të planit të Gadishmerisë në rastet e emergjencave civile për shkak të përdorimit të digave të mëdha të Sharrdushk, Patku 2 dhe Okshtun. Ky plan duhet të përgatitet sipas udhëzimeve të dhëna në Vendimin e KKDM Nr.5, datë 16.11.2020;
 - Përgatitjen e Projektit të Zbatimit për rehabilitimin e digës së Sharrdushkut dhe dorëzimin e tij pranë KKDM për miratim sipas legjislacionit të mësipërm
 - Informimin e KKDM në lidhje me zbatimin e kërkesave të mësipërme brenda muajit Qershor 2023

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

